



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT DHE
MENAXHIMIT TË KONTRATAVE TË INFRASTRUKTURËS**

**LABORATOR I INDUSTRIË KREATIVE DHE
MUZEALIZIMI INOVATIV I QENDRËS TURISTIKE
VOSKOPOJË**

SPECIFIKIME TEKNIKE

Tabela permbledhese

1. Heqje pllaka trotuari ekzistues
2. Shtrese me pllaka guri 4 cm
3. Heqje bazamake te shkallve
4. Transport materile ndërtimi dheu deri në 10 km
5. Ndërtim muri gips dy shtresa $t=0$ cm me dy shtresa kunder lageshtires
6. Hidroizolim me dy component shtresa astar me baze cemento
7. Lyerje muri me Boje hidroplastike importi cilesi e larte (per jashte)
8. Lyerje me Boje hidroplastike (per Brenda)
9. Pastrim fasade
10. F.V. Plintuese guri , $h=12$ cm
11. Parapet shkalle metalike
12. Veshje fasade me travertine (Veshja e Lapidarit ekzistues)
13. Fugature llac cemento M – 50 (sheshi I lapidarit)
14. Konstruksione metalike te thjeshta
15. F. V. dyer duroplasti dopjo xham
16. Heqje parmake druri shkalle
17. Heqje dyer ekzistuese
18. Ulluqet horizontale bakri
19. Tubat e shkarkimit
20. Rakorderite
21. Heqje pllaka trotuari
22. Shtrese me pllaka grez importi
23. Germim dheu me krah
24. Hidroizolim murature
25. Suvatim brenda mur tulle
26. Patinim i tavaneve
27. Ndërtim drenazhi, mbushje me zhavorr + PVC 200 mm
28. Gjeotekstil

**29. Ndriçues LED (te brendshem),
spot + llampe+ aksesore te montimit**

30. Ndricues (te jashtem)

31. Kondicionere

32.Grila rol -on

1. Heqje pllaka trotuari ekzistues

Bordura betoni për trotuarë Trotuarët, rrugët si dhe pjesët e tjera të shtruara prej asfalti, pllakave të betonit ose prej ndonjë materiali tjetër duhet që të mbrohen në atë mënyrë, që anëve t'u vendoset nga një mbështetëse. Bordura mbështetëse duhet të plotësojë kërkesat e lartëpërmendura për të mbajtur sipërfaqen e shtruar prej forcave horizontale, të cilat shkaktohen nga lëvizja e forcave vertikale, prej makinave, njerëzve, etj. Një funksion tjetër që u shtohet atyre, është që të drejtojnë ujrën e rrugës. Bordurat mund të vendosen në të njëjtën lartësi me sipërfaqen e shtruar ose të jenë nga 10 cm deri në 30 cm më lartë nga rruga sipas nevojës. Materiali i bordurave duhet të jetë prej betoni ose prej guri. Zgjedhja e tij duhet bërë nga arkitekti/Supervizori së bashku me klientin dhe duhet pasur parasysh se materiali i zgjedhur luan një rol të veçantë në dekorimin e sipërfaqeve. Materiali i bordurave duhet të jetë prej betoni ose prej guri. Zgjedhja e tij duhet bërë nga arkitekti/Supervizori së bashku me klientin dhe duhet pasur parasysh se materiali i zgjedhur luan një rol të veçantë në dekorimin e sipërfaqeve.



2. Shtrese me pllaka guri 4 cm

Shtirim me pllaka guri. Pllaka guri me trashësi 4cm që e percakton investitori dhe supervizori të vendosura mbi shtresë rere si dhe çdo detyrim tjetër dhe mjeshteri për mbarimin e punës në mënyrë perfekte. Pllaka të zgjidhet nga përfaqësuesi i sipërmarresit, nga supervizori dhe përfaqësuesi i Bashkisë. (cilësia, dimensionet dhe ngjyra e saj të jenë të njëjta si ato në pjesën e godinës ekzistuese).

3. Heqje bazamake te shkallve

Bazamakët ekzistues të shkallës janë prej druri po ashtu si dhe veshja e shkëljes së secilës shkalle. Do të bëhet çmontimi i shkallëve ekzistues. Heqja e bazamakeve dhe sistemit të materialit që rezultojnë, brenda ambientit të kantonit, duke përfshirë perzgjedhjen e mundshme dhe vendin më të mirë në një vend të caktuar të kantonit për ripërdorim.



4. Transport materiale ndërtimi dheu deri në 10 km

Transporti i të gjitha materialit të nxjerrë nga prishja e objektit do të transportohet me mjetet e përcaktuara drejt venddepozitimit të përcaktuar nga njësi e qeverisjes qendrore.

5. Ndërtim muri gipsi dy shtresa $t=0$ cm me dy shtresa kundër lagështirës

Ky ze punimesh do të vendoset në objektin në laboratorin e Industrisë Kreative po ashtu edhe në muzealizimin Inovativ të Qendrës Turistike Voskopoje. Ky ze punimesh do të përfshijë montimin e murit prej kartoni gipsi. Metodat e montimit të mureve prej gipskartoni duhet të merren nga prodhuesi. Edhe pse montimi i tyre nuk ndryshon shumë nga njëri - tjetri prodhues i sistemeve të gipskartonit, duhet të zbatohen rregullat e montimit, të cilat i jep dhe për të cilat garanton prodhuesi. Sistemi i mureve prej gipskartoni përbëhet nga këto komponente: • Pllakë prej gipskartoni: Pllakat në përgjithësi kanë këto dimensione: 62.5 cm x 250 cm dhe 125 cm x 250 cm, kurse trashësia është 12,5 mm ose 15 mm. Për të arritur mure më të mira për hermetizimin e zhurmave ose kundër zjarrit, mundën nga secila anë e murit

të vendosen nga dy pllaka njëra sipër tjetrës dhe hapësira ndërmjet dy faqeve të mbushet me material termoizolues dhe bllokues zhurmash. Pllakat duhet të jenë të shenjuara për ambiente të thata apo me lagështirë prej prodhuesit.

- Konstruksioni mbajtës Konstruksionet mbajtëse i ndajmë në dy lloje, sipas materialit që përdoret për këtë qëllim:
 - Metalikë (llamarinë) me trashësinë prej 50, 75 ose 100 mm për shinat që vendosen lartë dhe poshtë, kurse shinat që vendosen (futen) në shinat e lartpërmendura kanë trashësinë 48.8, 73.8 ose 98.8 mm. Për këtë shiko figurën Nr. 1;
 - Druri (ristela) me dimensione, të cilat varen prej materialit termoizolues dhe bllokues zhurmash. Për këtë shiko figurën Nr. 2.
- Konstruksioni mbajtës në drejtimin vertikal duhet vendosur secili 62,5 cm. Ky konstruksion së bashku me shinat që vendosen poshtë dhe lart, rrisin shkallën e stabilitetit në murin që ndërtohet.
- Materiali termoizolues, mbrojtës ndaj zjarrit dhe bllokues zhurmash Ky material kryen të treja funksionet e lartpërmendura. Materiali futet ndërmjet plakave dhe ndërmjet konstruksionit mbajtës. Trashësia e tij duhet të jetë min. 50 mm për të garantuar një kalim zhurmash vetëm 50 db, gjë që është brenda normave të lejuara. Ai duhet të ketë rezistencë kundër zjarrit prej më së pakti 30 minuta. Ky material përbëhet kryesisht nga lesh xhami natyror ose komponentë të tjera, që gjenden në treg dhe që plotësojnë kushtet e mësipërme.
- Materiale të tjera për këto mure janë vidat, gozhdat, rripi i mbylljes së fugave, pluhur gipsi për të mbushur fugat, etj Kombinimi i komponentëve të lartpërmendur lejojnë një variacion në prodhimin e këtyre mureve. Poshtë janë përmendur disa kombinime, që janë të mundshme në rast të përdorimit të konstruksionit mbajtës prej metali:
 - Konstruksioni mbajtës njëfish, plakat njëfish.
 - Konstruksioni mbajtës njëfish, plakat dyfish
 - Konstruksioni mbajtës dyfish me hapësirë ndërmjet, pllakat njëfish ose dyfish

Sistemi i kartongipsit mund të përdoret edhe në raste të restaurimit të mureve të dëmtuar. Atëherë konstruksioni mbajtës mbështetet në murin ekzistues dhe pastaj mbi të montohen pllakat. Në rast se ka nevojë, është e mundur që ndërmjet murit të vjetër/dëmtuar dhe pllakës, të futet materiali termoizolues për rritjen e shkallës së izolimit. Sistemi i murit prej kartongipsi mund të përpunohet si çdo mur tjetër. Ai mund të lyhet me çdo lloj boje, në të mund të bëhen instalimet elektrike dhe hidraulike si dhe në atë mund të instalohen të gjitha llojet e pllakave prej qeramike.

6. Hidroizolim me dy component shtresa astar me baze cemento

Hidroizolim me emulsion bitumi dhe dy shtresa katrama Ky zë është element krejtësisht i ri në çatinë e objektit. Aktualisht çatia nuk ka një shtresë hidroizoluese. Hidroizolimi do të bëhet duke I mbivendosur shtresat (rreth 12-15 cm). Në pjesën fundore të çatisë, ku objekti takohet me objektin nr. 1, shtresa hidroizoluese do të ngrihet në murin vertical (të objektit nr. 1) me minimum 15 cm, në zonën ku do të vendoset më vonë impluvi I llamarinës, në mënyrë që të arrihet izolimi I plotë nga lagështira

7. Lyerje muri me Boje hidroplastike importi cilesi e larte (per jashte)

Përpara fillimit të punimeve, kontraktori duhet ti paraqesë për aprovim Supervizorit, markën, cilësinë dhe katalogun e nuancave të ngjyrave të bojës, që ai mendon të përdorë. Të gjitha bojërat që do të përdoren duhet të zgjidhen nga një prodhues që ka eksperiencë në këtë fushë. Nuk lejohet përzierja e dy llojeve të ndryshme markash boje gjatë procesit të punës. Hollimi i bojës duhet të bëhet vetëm sipas udhëzimeve të prodhuesit dhe aprovimit të Supervizorit. Furçat, kovat dhe enët e tjera ku mbahet boja duhet të jenë të pastra. Ato duhet të pastrohen shumë mirë përpara çdo përdorimi sidomos kur duhet të punohet me një ngjyrë tjetër. Gjithashtu, duhet të pastrohen kur mbaron lyerja në çdo ditë. Personeli që do të kryejë lyerjen, duhet të jetë me eksperiencë në këtë fushë dhe duhet të zbatojë të gjitha kushtet teknike të lyerjes sipas KTZ dhe STASH. Lyerja me bojë hidroplastike importi cilësi e pare e sipërfaqes. Para lyerjes duhet të bëhet mbrojtja e sipërfaqeve që nuk do të lyhen (dyer, dritare, etj.) me anë të vendosjes së letrave mbrojtëse. Në fillim të procesit të lyerjes bëhet paralyerja e sipërfaqeve të pastruara mirë me gëlqere të holluar (astari). Në fillim bëhet përgatitja e astarit sipas përzierjes së rekomanduar nga furnizuesi. Me përzierjen e përgatitur bëhet paralyerja e sipërfaqes vetëm me një dorë. Në raste të veçanta përgatitet një dorë solucion lidhës e formuar me rrëshirë të hollë me 50 % ujë dhe e zbatuar me penel ose rulon mbi mure. Më pas vazhdohet me lyerjen me bojë. Lyerja bëhet me dy duar me boje në një distance kohe të nevojshme për tharje të dorës së parë. Sipërfaqja të jetë uniforme dhe pa njolla.

8. Lyerje me Boje hidroplastike (per Brenda)

Përpara fillimit të punimeve, kontraktori duhet ti paraqesë për aprovim Supervizorit, markën, cilësinë dhe katalogun e nuancave të ngjyrave të bojës, që ai mendon të përdorë. Të gjitha bojërat që do të përdoren duhet të zgjidhen nga një prodhues që ka eksperiencë në këtë fushë. Nuk lejohet përzierja e dy llojeve të ndryshme markash boje gjatë procesit të punës. Hollimi i bojës duhet të bëhet vetëm sipas udhëzimeve të prodhuesit dhe aprovimit të Supervizorit. Furçat, kovat dhe enët e tjera ku mbahet boja duhet të jenë të pastra. Ato duhet të pastrohen shumë mirë përpara çdo përdorimi sidomos kur duhet të punohet me një ngjyrë tjetër. Gjithashtu, duhet të pastrohen kur mbaron lyerja në çdo ditë. Personeli që do të kryejë lyerjen, duhet të jetë me eksperiencë në këtë fushë dhe duhet të zbatojë të gjitha kushtet teknike të lyerjes sipas KTZ dhe STASH. Lyerja me bojë hidroplastike importi cilësi e pare e sipërfaqes. Para lyerjes duhet të bëhet mbrojtja e sipërfaqeve që nuk do të lyhen (dyer, dritare, etj.) me anë të vendosjes së letrave mbrojtëse. Në fillim të procesit të lyerjes bëhet paralyerja e sipërfaqeve të pastruara mirë me gëlqere të holluar (astari). Në fillim bëhet përgatitja e astarit sipas përzierjes së rekomanduar nga furnizuesi. Me përzierjen e përgatitur bëhet paralyerja e sipërfaqes vetëm me një dorë. Në raste të veçanta përgatitet një dorë solucion lidhës e formuar me rrëshirë të hollë me 50 % ujë dhe e zbatuar me penel ose rulon mbi mure. Më pas vazhdohet me lyerjen me bojë. Lyerja bëhet me dy duar me boje në një distance kohe të nevojshme për tharje të dorës së parë. Sipërfaqja të jetë uniforme dhe pa njolla.

9. Pastrim fasade

Në punimet e konservimit të muraturave në pjesën më të madhe i takojnë punimeve të fugatimit. Fugat që do të nënshtrohen këtij procesi, do të evidentohen plotësisht vetëm pasi të jetë bërë pastrimi i

vegjetacionit nga territori përreth dhe nga sipërfaqja e strukturës. Do të fugatohen të gjithë pjesët e muraturës, sipërfaqeve horizontale të strukturës ku ka vegjetacion si dhe pjesët ku materiali lidhës është i degraduar.

Pasi të pastrohet eliminohet vegjetacioni, muret do të shplahen me ujë në mënyrë që të ekspozohen llaçi dhe fugat. Pjesët ku ka pasur rrënjë si dhe në ato pjesë ku llaçi është i dobët do të pastrohen nga llaçi i degraduar me furçë të butë teli dhe pasi të pastrohen nga të gjitha mbetjet organike do të rimbushen me llaç të ri. Fugat duhet të mbushen deri në planin e murit, që të krijojë sipërfaqe të njëjta me tipin e fugatimit të përdorur në teknikën origjinale të muraturës ekzistuese dhe që në asnjë rast të mos ndodhë mbajtja e ujit apo dherave që sjell era. Llaçi duhet të jetë me gëlqere hidraulike në raportin 1 masë gëlqere hidraulike dhe 1 masë rërë e ashpër.

10. F.V. Plintuese guri , h=12 cm

Plintuse guri ,h=12cm do te konsistoje ne: Blerjen e plintuseve gurit dhe kolles dhe montimin e tyre ne objekt.

11. Parapet shkalle metalike

Korimanot metalike Korimanot në ndërtime kanë funksione të ndryshme për të plotësuar. Ata duhet të ofrojnë mbrojtje dhe siguri gjatë të ecurit në shkallë. Po ashtu, korimanot luajnë një rol të veçantë në pamjen dhe bukurinë arkitektonike të një ndërtimi. Duhet që korimonat të jenë të larta 90 cm. Masa prej 80/90 cm varet edhe prej sipërfaqes të sheshpushimit. Korimanot montohen në shkallë ose anash shkallëve, të fiksuara mirë që të garantohet stabiliteti dhe qëndrueshmëria e tyre. Në rastet kur shkallët janë më të gjera se 100 cm, atëherë duhet që përveç korimaneve, vendosen në muret e anës tjetër të shkallëve, parrakë për të siguruar një ecje të sigurt. Parrakët, preferohet të vendosen prej një materiali dhe forme të tillë, që prekja e tyre të jetë e lehtë dhe pa dëmtime.

Korimanot metalike do te realizohen njelloj me korrimanot ekzistues ne objekt.




12. Veshje fasade me travertine (Veshja e Lapidarit ekzistues)

13. Fugature llac cemento M – 50 (sheshi I lapidarit)

Fugaturë llac çimento, në pjesën e poshtme dhe rrethuese të muraturës së jashtme, e suvatur si më sipër, dhe e realizuar me llac çimentoje m-1:2, me dozim për m³: çimento 400 kg 527, rërë e larë m³ 0.89 dhe ujë, me lartësi dhe formë sipas udhëzimeve në projekt, duke përfshirë kallëpet ose fashaturat e mundshme si dhe çdo detyrim tjetër për t'i dhënë plotësisht fund xokolaturës në mënyrë perfekte.

14. Konstruksione metalike te thjeshta

Keto element do te perdoren ne Objekti Muzealizimi Inovativ i Qendres Turistike Voskopoje. Parapeti i shkalleve kryesore ne object do te behet me kanxhella metalike, si shkallet metalike ekzistuese te objektit. Po ashtu edhe shkallet metalike e gurit ne objekti I dyte ne voskopoje do te behet nje shtese parapet metalik si ne projekt. Te shihen shkallet e vizatuara ne projekt.



Të dhëna të përgjithshme Në projektimin e konstruksioneve prej çeliku, duhen marrë parasysh kërkesat që pasqyrojnë veçoritë e punës së këtyre konstruksioneve, më anë të udhëzimeve përkatëse në mbështetje të këtyre kushteve teknike. Soliditeti dhe qëndrueshmëria e konstruksioneve prej çeliku duhet të garantohet si gjatë procesit të shfrytëzimit, ashtu edhe gjatë transportimit dhe montimit. Prodhimi Prodhimi i çelikut duhet të jetë bërë nga kompani të licensuara dhe ata duhet të garantojnë për cilësinë si dhe të dhënat (përbërja kimike, karakteristikat e forcës/bajtëse, etj) e çelikut. Çeliku që përdoret për konstruksionet mbajtëse, duhet t'u përgjigjet kërkesave të standarteve dhe kushteve teknike përkatëse dhe të ketë garanci përse i përket kufirit të rrjedhshmërisë dhe përmbajtjes max. të squfurit dhe fosforit; kurse për konstruksionet e salduara, edhe për përmbajtjen max. të karbonit. Prerja, saldimi si dhe lidhja e elementeve prej çeliku bëhet në kantierin e firmës kontraktuese dhe ata transportohen në kantier ose këto punime mund të bëhen në vëndin e punës (në objekt). Sidoqoftë, duhet që punimet para

montimit të elementeve të kontrollohen nga Supervizori dhe duhet të protokollohen. Saldimi Përgatitja për saldim përfshin atë që detajet para se të saldohen, të kenë marrë formën e tyre përfundimtare. Po ashtu, buzët dhe sipërfaqet e pjesëve që do të saldohen duhet të përgatiten sipas kërkesave të procedurës së saldimit dhe formave që jepen në pasqyrat 6,7,8 të K.T.Z. 206-80 ose në ndonjë tjetër normë/standart evropian. Pas saldimit, detajet duhet të trajtohen termikisht për të zvogëluar ndarjet e brendshme, për të mënjeluar të plasurat dhe për të përmituar vetitë fiziko-mekanike. Gjatë zbatimit të punimeve për saldimitin e çelikeve duhet të mbahet dokumentacioni teknik më të dhëna për çertifikatën e materialeve të përdorura, ditarin e punimeve, etj. 25 Lidhja me bulona Elementët prej çeliku mund të lidhen/bashkohen edhe më anë të bulonave. Lidhja me bulona duhet t'u përgjigjet normave dhe standarteve bashkëkohore (EC 3 ose ndonjë norme të ngjashme). Kualiteti i bulonave luan një rol të rëndësishëm dhe këto të fundit po ashtu, duhet t'u përgjigjen normave dhe standarteve të lartpërmendura. Më shumë rëndësi është që ata t'i plotësojnë kushtet e rezistencës së llogaritjes të bashkimeve me bulona. Lloji i gjendjes së tensionuar dhe grupi i bashkimit, të cilat duhet të përmbushin kushtet e nevojshme/kërkuara nga normat/standartet janë këto: •Tërheqja •Prerja •Shtypja Gjatë zbatimit të punimeve për lidhjen me bulona të çelikeve duhet të mbahet dokumentacioni teknik më të dhëna për çertifikatën e materialeve të përdorura, ditarin e punimeve, etj. Se ç'mënyrë bashkimi (saldimi apo bulonat) do të përdoret, kjo duhet vendosur nga inxhinieri konstruktor sipas nevojës. Ngritja Ngritja e elementeve prej çeliku bëhet sipas planeve të përgatitura nga arkitekti/inxhinieri. Inxhinieri duhet të supervizojë punën e ngritjes. Punonjësit që do të merren me këtë punë duhet të kenë eksperiencë në ngritjen e elementeve prej çeliku. Mbrojtja nga agjentët atmosferikë Mbrojtja e çelikut bëhet në dy mënyra: •Duke e lyer çelikut me disa shtresa, të cilat e mbrojnë çelikut prej korrosionit. Ajo bëhet duke e lyer, zhytur ose duke e spërkatur me shtresa. Njëra shtresë është baza, kurse shtresa tjetër përdoret edhe si dekorim i elementit dhe mund të ketë ngjyrë të ndryshme. Materiali në të cilin do të vendosen shtresat duhet më parë të përpunohet dhe të jetë i lirë nga pluhuri, vaji si dhe nga ndryshku. Ndalohet rreptësisht lyerja e çelikeve për betonim me vajra. Matja në ton.

15. F. V. dyer duroplasti dopjo xham

Dyer duroplast Furnizimi dhe vendosja e dritareve, siç përshkruhet në specifikimet teknike me dimensione të dhëna nga kontraktori, përbëhen nga material duro plast, profilet e të cilit janë sipas standarteve Europiane EN 573-3 dhe janë profilem,e ngjyre te erret ekzakt si ato ekzistueset. Ngjyra e dyerve ne secilin objekt do te jete do të jetë sipas kërkesës së investitorit. Ne laborator i Industrise kreative do te behet zevendesimi i dyerve metalike metalike me dyer duro plast. Ato do te realizohen dyer te brendshme te cilat do te jene me dopio xham. Ndersa ne objekti ne Voskopoje “ Muzealizimi inovativ i Qendres turistike Voskopoje”, do te behet zevendesim i deres se tualetit. Ato janë të siguruar me elemente që shërbejnë për vendosjen dhe ankorimin në strukturat e murit, si dhe me pjesët e dala që shërbejnë për rrëshqitjen e skeletit të deres. Forma e profilit është tubolare me qëllim që të mbledhë gjithë aksesorët e saj. Profili i deres do të jetë me dimensione të tilla që do të mbulohet nga profili kryesor që do të fiksohet në mur. Te gjitha dyert duhet te jene te pajisura me brave dhe celes.

16. Heqje parmake druri shkalle

Heqje elemente te drurit ne drendesi te objektit te qendres se Turistike ne Voskopoje, (korrimano parapeti, sheshi i pushimit) Këta elementë janë të vendosur në objekt nga përdoruesit e objektit gjatë gjithë viteve të përdorimit. Për këtë arsye heqja e tyre duhet të bëhet me kujdes për të mos i dëmtuar

më tej elementët e dekorit ose vetë muraturën. Heqja e këtyre elementëve është përlogaritur të bëhet në një kohë shumë të shkurtër.

17. – Heqje dyer ekzistuese

Ne objekti Labororit të Industries Kreative do të hiqen dyert metalike ekzistuese dhe do të vendoren dyet të reja. Ndersa ne objekti në Voskopoje do të zevendesohet dyera e tualetit e që ndodhet në katin e parë e cila është aktualisht jashtë funksioni.

Heqja e tyre nga vendi do të bëhet manualisht, duke çmontuar menteshat që i mbajnë dyert të lidhura në muraturë. Çmontimi i një dërrë është përlogaritur të realizohet në një kohë jo më të gjatë se 1 orë. Gjendja e dërrëve në Laboratori të Industrisë Kreative nuk është e mirë ndaj duhet të ruhen dhe vendosen në një vend të sigurt ku mund të riperdoren .

18. Ulluket horizontale bakri

Ulluket horizontale me baker 33cm

Realizohen me pjerrësi prej 1% për largimin e ujërave. Ulluket horizontale prodhohen me material bakri. Ulluku me llamarinë prej bakri me trashësi jo më të vogël se 0,8 mm, i formuar nga pjesë të modeluara me mbivendosje minimale 5 cm, të salduara në mënyrë të rregullt me kallaj, me bord të jashtëm 2 cm më të ulët se bordi i brendshëm, të kompletuara me pjesë speciale për grykën e hyrjes. Ulluku horizontal, duhet të jetë i lidhur me tel xingato me hallka të forta të vëna maksimumi në 70 cm

19. Tubat e shkarkimit

Për shkarkimet e ujërave do të përdoren tuba plastike PVC që plotësojnë të gjitha kërkesat e cilësisë sipas standartit ISO 4427 dhe prEN 12201. Këto tuba duhet të sigurojnë rezistencë perfekte ndaj korrozionit, rezistencë të lartë ndaj agentëve kimikë, peshë të lehtë, mundësi të thjeshta riparimi, transporti dhe lidhje, ngjitje të thjeshtë dhe të shpejtë. Përmasat e tubave do të jenë në funksion të sasisë llogaritëse të ujit të ndotur, shpejtësisë së lëvizjes dhe shkallës së mbushjes së tyre. Gjatë llogaritjeve, shpejtësia e lëvizjes duhet të merret 1-2 m/sek kurse shkalla e mbushjes duhet të jetë 0,5 - 0,8 e seksionit të tubit. Gjatësia e tubave duhet të jetë 6-10 m kurse diametri dhe spesori duhet të jenë sipas të dhënave në vizatimet teknike. Të dhënat mbi diametrin e jashtëm të tubit, presionin, emrin e prodhuesit, standartit që i referohen, viti i prodhimit, etj duhet të jepen të stampuara në çdo tub. Tubat e shkarkimit duhet të vendosen në të gjithë lartësinë e ndërtesës, në formën e kollonave, në ato nyje sanitare ku aparatet janë më të grupuara dhe mundësisht sa më afër atyre nyjeve që mbledhin me shumë ujëra të ndotura dhe ndotje më të mëdha. Tubat e shkarkimit lidhen me pajisjet sanitare ose grup pajisjesh në çdo kat me anë të tubave të dërgimit. Lidhja e tubave të dërgimit me kollonat e shkarkimit duhet të bëhet me tridegëshe të pjerrëta nën një kënd 45 ose 60 gradë. Është e detyrueshme lidhja e tubave në kënd 90 gradë. Tubat e dërgimit mund të shtrohen anës mureve, mbi ose nën soletë duke mbajtur parasysht kushtet e caktuara për montimin e rrjetit të brendshëm të kanalizimeve. Tubat e dërgimit duhet të jenë tuba PVC me të njëjtat karakteristika teknike të dhëna më sipër. Gjatësia e këtyre tubave nuk duhet të jetë më tepër se 10 m. Diametri i tyre do të jetë në funksion të daljeve të pajisjeve sanitare që janë vendosur. Për të pakësuar numrin e kollonave duhet që pajisjet sanitare të grupohen dhe të vendosen njëri mbi tjetrin nga kati në kat të ndërtesës. Çdo kollonë vertikale e shkarkimit pajiset me pika kontrolli të cilat duhet të vendosen në çdo dy katë duke filluar nga pjesa e poshtme e kollonës. Diametri i kollonave të shkarkimit merret i njëjtë për të gjithë lartësinë e ndërtesës dhe në asnjë mënyrë më i vogël

se tubi më i madh i dërgimit të ujrave të ndotura që lidhet me të. Nuk lejohet përdorimi i tubave të shkarkimit me diametër më të vogël se 50 mm. Të gjitha punët e lidhura me instalimin dhe vendosjen e tyre në objekt duhet të bëhen sipas kërkesave teknike të supervizorit dhe të projektit. Bashkimet e tubave të shkarkimit duhet të bëhen me mastik të përshtatshëm për tuba PVC i rekomanduar nga prodhuesi i tubave. Kur toka në dyshtim është e dobët, tubacionet e shkarkimit duhet të vendosen në kanal betoni ose tulle. Provat hidraulike bëhen me presion provë 25% më të lartë se presioni i punës. Ato bëhen për të parë qëndrueshmërinë e rrjetit, si dhe rrjedhjet e mundshme që mund të ndodhin në tabacionet. Një model i tubit PVC që do të përdoret sëbashku me çertifikatën e cilësisë, çertifikatën e origjinës, çertifikatën e testimit dhe të garancisë së tubave do ti jepet për shqyrtim Supervizorit për një aprovim para se të vendoset në objekt. Supervisor mund të bëjë teste plotësuese për të dhënat fizike - mekanike të tubave dhe të materialit ngjitës të tyre.

20. Rakorderite

Rakorderitë për tubat e shkarkimit të ujrave Për lidhjen e tubave të shkarkimit me njëri tjetrin si dhe me pajisjet sanitare apo grupet e tyre do të përdoren rakorderitë përkatëse me material plastik PVC, që plotësojnë të gjitha kërkesat e cilësisë sipas standartit ISO 4427 dhe prEN 12201. Këto rakorderi (pjesë bashkuese) duhet të sigurojnë rezistencë ndaj korrozionit, rezistencë të lartë ndaj agjentëve kimike, peshë të lehtë, mundësi të thjeshta riparimi, transporti dhe lidhje, ngjitje të thjeshtë dhe të shpejtë. Përmasat (diametri) e tyre do të jenë në funksion të sasisë llogaritëse të ujit të ndotur, llojit të pajisjeve sanitare, shpejtësisë së lëvizjes së ujit dhe diametrave të tubave përkatës. Gjatë llogaritjeve, shpejtësia e lëvizjes së ujit duhet të merret 1-2 m/sek kurse shkalla e mbushjes do të jetë 0,5-0,8 e seksionit të tubit. Diametri dhe spesori i tyre duhet të jenë sipas të dhënave në vizatimet teknike. Të dhënat mbi diametrin e jashtëm, gjatësitë, presionin, emrin e prodhuesit, standartit që i referohen, viti i prodhimit, etj duhet të jepen të stampuara në çdo rakorderi. Rakorderitë e bashkimit të tubave duhet të montohen në të gjithë vendet ku bëhet bashkimi me tubat e dërgimit të ujrave të ndotura. Lidhja e tubave të dërgimit me kollonat e shkarkimit, duhet të bëhet me tridegëshe të pjerrëta ose brryla të thjeshtë nën një kënd 45 ose 60 gradë. Rakorderitë e bashkimit duhet të jenë tuba PVC me të njëjtat karakteristika teknike të dhëna më sipër. Gjatësia e tyre duhet të jetë sipas kërkesave të projektit. Diametri i tyre do të jetë në funksion të daljeve të pajisjeve sanitare që janë vendosur. Diametri i rakorderive duhet të jetë i njëjtë me diametrin e tubit të shkarkimit ku do të lidhet dhe në asnjë mënyrë më i vogël se tubi më i madh i dërgimit të ujrave të ndotura që lidhet me të. Në rastet e ndryshimit të diametrit të tubave të shkarkimit dhe të dërgimit, rakorderitë duhet t'i përshtaten secilit prej tyre. Të gjitha punët e lidhura me instalimin dhe vendosjen e tyre në objekt duhet të bëhen sipas kërkesave teknike të supervizorit dhe të projektit. Bashkimet e rakorderive me tubat e shkarkimit, bëhen me mastik të përshtatshëm për tuba PVC i rekomanduar nga prodhuesi i tubave. Një model i rakorderive përkatëse PVC që do të përdoret, së bashku me çertifikatën e cilësisë, çertifikatën e origjinës, çertifikatën e testimit dhe të garancisë së tubave do ti jepet për shqyrtim supervizorit për një aprovim para se të vendoset në objekt. Me kërkesë të veçantë të Supervizorit, mund të bëhen teste plotësuese për të dhënat fizike - mekanike të tubave dhe të materialit ngjitës të tyre.

21. Heqje pllaka trotuari

Bordura betoni për trotuarë Trotuarët, rrugët si dhe pjesët e tjera të shtruara prej asfalti, pllakave të betonit ose prej ndonjë materiali tjetër duhet që të mbrohen në atë mënyrë, që anëve t'u vendoset nga një mbështetëse. Bordura mbështetëse duhet të plotësojë kërkesat e lartëpërmendura për të mbajtur sipërfaqen e shtruar prej forcave horizontale, të cilat shkaktohen nga lëvizja e forcave vertikale, prej makinave, njerëzve, etj. Një funksion tjetër që u shtohet atyre, është që të drejtojnë ujrat e rrugës.

Bordurat mund të vendosen në të njëjtën lartësi me sipërfaqen e shtruar ose të jenë nga 10 cm deri në 30 cm më lartë nga rruga sipas nevojës. Materiali i bordurave duhet të jetë prej betoni ose prej guri. Zgjedhja e tij duhet bërë nga arkitekti/Supervizori së bashku me klientin dhe duhet pasur parasysh se materiali i zgjedhur luan një rol të veçantë në dekorimin e sipërfaqeve. Materialet që i ofron tregu janë të këtij lloji: Bordura betoni për trotuarë Trotuarët, rrugët si dhe pjesët e tjera të shtruara prej asfalti, pllakave të betonit ose prej ndonjë materiali tjetër duhet që të mbrohen në atë mënyrë, që anëve t'u vendoset nga një mbështetëse. Bordura mbështetëse duhet të plotësojë kërkesat e lartëpërmendura për të mbajtur sipërfaqen e shtruar prej forcave horizontale, të cilat shkaktohen nga lëvizja e forcave vertikale, prej makinave, njerëzve, etj. Një funksion tjetër që u shtohet atyre, është që të drejtojnë ujrat e rrugës. Bordurat mund të vendosen në të njëjtën lartësi me sipërfaqen e shtruar ose të jenë nga 10 cm deri në 30 cm më lartë nga rruga sipas nevojës. Materiali i bordurave duhet të jetë prej betoni ose prej guri. Zgjedhja e tij duhet bërë nga arkitekti/Supervizori së bashku me klientin dhe duhet pasur parasysh se materiali i zgjedhur luan një rol të veçantë në dekorimin e sipërfaqeve.

22.Shtrese me pllaka grez importi

Pllakat do të vendosen në tualet e parashikuara për rinovim në objektin e qendres Voskopojë. Tualetet janë të pozicionuara në katin e dytë dhe do të bëhet ndryshimi i tubane dhe rakorderive.

Klasifikimi i pllakave bëhet sipas këtyre kriterëve:

- Mënyra e dhënies së formës të pllakës
- Marrja e ujit
- Dimensionet e pllakave
- Vetitë e sipërfaqes
- Veçoritë kimike
- Veçoritë fizike
- Siguria kundër ngricës
- Pesha/ngarkesa e sipërfaqes
- Koeficienti i rrëshqitjes

Tabelat e mëposhtme përshkruajnë disa prej këtyre kriterëve.

Pllakat duhen zgjedhur për secilin ambient, duke marrë parasysh nevojat dhe kriteret, që ato duhet t'i përmbushin. Kriteret dhe tabelat e lartpërmendura mund të ndihmojnë në zgjedhjen e tyre.

I	$E < 3 \%$
II a	$3 \% < E < 6 \%$
II b	$6 \% < E < 10 \%$
III	$E > 10 \%$

Klasat e kërkesave/ngarkimit		
Klasa	Ngarkesa	Zona e përdorimit, psh

SPECIFIKIME TEKNIKE

I	shumë lehtë	Dhoma fjetëse, Banjo
II	e lehtë	Dhoma banuese përveç kuzhinës dhe paradhomës
III	e mesme	Dhoma banuese, ballkone, banjo hotelesh
IV	rëndë	Zyra, paradhoma, dyqane
V	shumë e rëndë	Gastronomi, ndërtesa publike

Për shkolla dhe kopshte, duhet që pllakat të jenë të Klasës V, me sipërfaqe të ashpër, në mënyrë që të sigurojnë një ecje të sigurtë pa rrëshqitje.

Në ambientet me lagështirë (ËC, banjo e dushe) duhet të vendosen pllaka të klasës I, që e kanë koeficientin e marrjes së ujit $< 3\%$.

Për këtë duhet që përpara fillimit të punës, kontraktori të paraqesë tek Supervizori disa shembuj pllakash, së bashku me certifikatën e tyre të prodhimit dhe vetëm pas aprovimit nga ana e tij për shtrimin e tyre, sipas kushteve teknike dhe rekomandimeve të dhëna nga prodhuesi.

23. Germim dheu me krah

Germim dheu për themele ose për punime nëntokësore, deri në thellësi 2,5 m nga rrafshi i tokës, në truall të çfarëdo natyre dhe konsistence, të tharë ose të lagur (argjilë edhe n.q.s. është kompakte, rërë, zhavorr, gurë etj.) duke përfshirë prerjen dhe heqjen e rrënjëve, trungjeve, gurëve, dhe pjesëve me volum deri në 0.30 m³, plotësimin e detyrimeve në lidhje me ndërtimet e nëndheshme si kanalet e ujrave të zeza, tubacionet në përgjithësi etj..

Materiali i përstatshëm dhe materiali i rimbushur nga punë të përkohshme do të përdorën për rimbushje. Çdo material i tepërt do të jetë në dispozicion të mungesave të materialeve të kërkuara.

24. Hidroizolim murature

Hidro- izolimi i muratures do të preke kryesisht objektin e ndodhur në Qendren turistike, Voskopoje, të dy objektet që bëjnë pjesë në këtë projekt.

Hidro – izolimi i tyre do të përfshijë një sërë elementesh. Kërkohej që zbatim i këtij procesi bëhet në kushte atmosferike optimale për të nderhyrë në hidro- izolim të fasadave të ekzistues. Në fasada do të pastrohet vendi ku do të nderhyhet duke e prishur një pjesë të suvase ekzistuese me pas siperfaqja e objektit do të lyhet me boton kontakt për të bërë lidhjen e hidro - izolimit me murin. Aplikohet astari Tecnofix Liquid dhe me pas hidro izolimi me Izolastic 2 komponent. Mbi Izolastic bëhet me DW Conexion 99 dhe me pas lyhet me boje.

Hidroizolimi Hidroizolimi duhet shtrirë në një sipërfaqe të thatë, të niveluar më parë, duke përfshirë sipërfaqe vertikale, të trajtuara me shtresë të parë bituminoze si veshje e parë. Mbi këtë vendosen dy fletë bituminoze, me fibër minerale, secila me trashësi min. 3 mm, e ngjitur me flakë, me membrana të vendosura në këndet e dhura mbi njëra - tjetrën, në sipërfaqe të pjerrëta ose vertikale, duke u siguruar se mbulesa e elementeve të bashkuara të jetë 12 cm. Mbrojtja e membranës izoluese me plan vertikal ose të pjerrët do të realizohet me shtresë llaç ose plaka çimentoje me trashësi 3 cm (tipi i llaçit 1:2), pllakat ose shtresa e llaçit do të realizohet në formë kuadrati 2 x 2 m, me fuga nga 2 cm, të cilat do të mbushen me bitum sipas kërkesave të dhëna në vizatime. Instalimi i parapeteve betoni me kanale kulluese të inkuorporuara, në beton të forcuar, të parafabrikuara ose të derdhura në vend sipas të dhënave në skica, beton (tipi 200) në dozim m³ siç është treguar në 4.1.4, duke përfshirë kallëpet në

përputhje me të gjitha kërkesat për të siguruar tarracën, me një punë me cilësi. Në rastet kur hidroizolimi i taracës bëhet kur nuk ka llustër çimentoje mbi shtresat e katramave, atëherë vendoset një shtresë prej 5 cm, me zhavor të rrumbullakët me dimension 32 mm –64 mm, e cila shërben për mbrojtjen e katramasë.

25. Suvatim brenda mur tulle

Sprucim i mureve dhe tavaneve me llaç çimentoje të lëngët, për përmirësimin e ngjithësisë së suvasë dhe rforcimin e sipërfaqeve të muraturës, duke përfshirë skelat e shërbimit dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht sprucimin.

Suvatim i realizuar nga një shtresë me trashësi 2 cm llaçi bastard m-25 me përmbajtje për m²: rërë e larë

0,005 m³; llaç gëlqereje m- 1: 2, 0.03 m³; çimento 400, 6.6 kg; ujë, i aplikuar me paravendosje të drejtuesve në mure (shiritit me llaç me trashësi 15 cm çdo 1 deri në 1,5 m), dhe e lëmuar me mistri e

bërdaf, duke përfshirë skelat e shërbimit si dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht suvatimin.

Suvatim xhokoli

Suvatim xhokoli me granil e çimento të zak , me spruco.

- **Xokolaturë me llaç çimento**

Xokolaturë llaç çimento, në pjesën e poshtme dhe rrethuese të muraturës së jashtme, e suvatuar si më sipër, dhe e realizuar me llaç çimentoje m-1:2, me dozim për m³: çimento 400 kg 527, rërë e larë m³ 0.89 dhe ujë, me lartësi dhe formë sipas udhëzimeve në projekt, duke përfshirë kallëpet ose fashaturat e mundshme si dhe çdo detyrim tjetër për t'i dhënë plotësisht fund xokolaturës në mënyrë perfekte.

Patinimi

Patinaturë muri realizohet me stuko, çimento dhe me gëlqere të cilësisë së lartë, mbi sipërfaqe të suvatuara më parë dhe të niveluara, me përmbajtje: gëlqere 3 kg për m². Lartësia e patinaturave për ambientet e ndryshme të ndërtesës duhet të vendoset nga Supervizori, përfshirë dhe çdo punë tjetër dhe kërkesë për ta konsideruar patinaturën të përfunduar dhe të gatshme për tu lyer me çdo lloj boje.


26. Patinim i tavaneve

Patinaturë e tavaneve realizohet me stuko, çimento dhe me gëlqere të cilësisë së lartë, mbi sipërfaqe të paneleve të gipsit ose sipërfaqeve të suvatuara e të niveluara të tavaneve më parë, me përmbajtje: gëlqere 3 kg për m². Lartësia e patinaturave për ambientet e ndryshme të ndërtesës duhet të vendoset nga Supervizori, përfshirë dhe çdo punë tjetër dhe kërkesë për ta konsideruar patinaturën të përfunduar dhe të gatshme për tu lyer me çdo lloj boje.

Patinaturë muri realizohet me stuko, çimento dhe me gëlqere të cilësisë së lartë, mbi sipërfaqe të suvatuara më parë dhe të niveluara, me përmbajtje: gëlqere 3 kg për m². Lartësia e patinaturave për ambientet e ndryshme të ndërtesës duhet të vendoset nga Supervizori, përfshirë dhe çdo punë tjetër dhe kërkesë për ta konsideruar patinaturën të përfunduar dhe të gatshme për tu lyer me çdo lloj boje.

27. Ndertim drenazhi, mbushje me zhavorr + PVC 200 mm

Germimi kryesor do të bëhet në kuotën 150 x 100 cm. Pasi të arrihet nxjerrja e themeleve do të vendoset materiali hidro – izolues gjeotekstil me gramaturë 180 gr/m². Mbi këtë material do të vendosen 2 shtresa me membrane të dhembëzuar e cila do të fiksohet në pjesën e sipërme të fasadës me struktura metalike fikse. Ky element do të mbështjellë mirë perimetrin e themeleve, në fund të tyre do të pozicionohet një tub i perforuar për drenaxhim. Shtresat e mbushur me zhavorr lumi, dhe mbi to mbushja do të bëhet me rere apo materialte të tjera nga germimi. Të zbatohen vizatimet në projekt.



28. Gjeotekstil


Shtrese avull izoluese me barriere alumini, vendosur përpara shtresës termoizoluese. Formimi i pjerresive mbi sipërfaqen plane me një shtese polisterol sipas udhëzimeve në projekt.

29. Ndriçues LED (te brendshëm), spot + llampe+ aksesore te montimit

Ndricimi i brendshëm i objektit të ndodhur në Voskopojë, “Muzealizimi Inovativ i Qendres Turistike, do të realizohet nëpërmjet spoteve LED sic është e parashikuar në projekt.

SPECIFIKIME TEKNIKE

Shina per vendosjen e spoteve Led do te jete 3 m e gjate, ne nje shine do te pozicionohen 3 spote. Ne secilen dhome do te kete te pozicionuar dy shina ne qender te dhomes, si ne katin perdhe po ashtu dhe ne katin e pare. Secili spot do te kete nje llambe prej 20 w




Shina te bardha 3 m secila.
3 spote te levizshme ne secilen shine.

30. Ndricules (te jashtem)

Ndricimi i jashtem i objektit te ndodhur ne Voskopoje, “Muzealizimi Inovativ i Qendres Turistike, do te realizohet nepermjet spoteve LED sic eshte e parashikuar ne projekt. Ato do te pozicionohen ne katin perdhe dhe ne katin e pare ne hapsirat e jashtme si ne projekt. Ndriculesit e jashtem do te jene spote led te pozicionura ne tavan. Preferohet ndricimi te jete natyral.





OBJEKTI 1

Shkalla 1-100

NDRICIMI

	Shine + spote 20 w secila
	Spote tavanore 20 w per jashte

31. Kondicionere

Kondicionere 12 BTU Inverter Mural. Keto pajisje do te pozicionohen ne objekti i ndodhur ne Voskopoje, “Muzealizimi Inovativ i Qendres Turistike”, nje ne zyren e katit perdhe dhe nje ne katin e pare.

Ato do te pozicionohen ne lartesi dhe pocion te tille ne faqet e murit qe mos te bendojne zhvillimite qe mudn te jene ne secilin ambien. Secili prej tyre kerkon nje lidhje me energjine eketrike e cila nuk duhet te jete e dukshme. Vendorsja e njesise qendrore te jashtme do te behet me keshillim te supervizorit te punimeve pasi ajo nuk mund te pozicionohet ne hapsirat e jashtme te fasades.




- Përmasat: 77.7x25x20.1 cm
- Niveli i zhurmës: 50/60 dB
- Sipërfaqja që mbulon: 14-22 m²
- Konsumi i energjisë në ftohje : 1.005 kW
- Konsumi i energjisë në ngrohje: 1.13 kW
- Fuqia: 12000 BTU
- Kapaciteti ftohës: 3.4 kW
- Kapaciteti i ngrohjes: 3.42 kW
- Klasi i energjisë: A++/A+
- Vëllimi i ajrit: 450 m³/h
- Lloji i gazit: R32
- Tensioni: 220-240 V
- Marka: Elektra

32.Grila rol -on

Grila prodhohet sipas gjerësisë dhe lartësisë së dëshiruar .Ky produkt lehtëson dhe e bën me komod ambientin. Gjërësia e grilës duhet ti përshtatet secilës dritare tek e cila do të vendoset.

- Mënyra e montimit: Në mur
- Përdorimi: I brendshëm
- Materiali: Copë
- Ngjyra : Bezhë
- Filtron dritën: Po

Në furnizim vendosje të grilës për ambientet e brendshme duhet të përfshihen dhe aksesoret për montimin e saj.



- Shina alumini për rrëshqitjen e grilës rulo


Secila dritare do të pajiset me nga dy shina alumini tek dy faqet anësore të saj, nëpër kanalin e së cilës do të lëvizë grila rulon. Ngjyra e shinës do të jetë gri (argjendi) dhe lartësia e saj do të jetë sa lartësia e dritares. Shina duhet të sigurojë rrëshqitjen pa pengesa të grilës duke lënë pak hapësirë nga të dyja anët por duke siguruar që grila mos dalë prej saj. Shinat do të mbërthehen në mur nëpërmjet 6 vidhave me upa (nga tre për secilin krah).



Shina e montuar me grilën

1. F.V Tavolina Pune mdf 120*75

SPECIFIKIME TEKNIKE



Specifikime Teknike:

- Lartesia 75cm
- Sipërfaqja e syprinës trashësi 2.3 cm
- Skeleti mbajtës – Strukturë laminat

Tavolina duhet të jetë me material laminant me bordurë të plastifikuar me trashësi 2.3 cm. Tavolinat do të jenë të bardha Material laminant me bordura të pastifikuara. Syprina do të ketë disa çarje rrethore, të mbuluar me aksesori përkatës, me diametër 5 cm për kalimin e kabllorëve në secilin pozicion të kompjuterit. Takimi në tokë me distanciatorë metalikë kundër lagështirës. Ngjyra do të jetë Ral 9001.

F.V. Karrige me strukturë druri (arrë), këmbë druri (arrë), tapiceri PU, me ngjyre pana , 54.5x56xH75 cm

Karriget e barit ju lejojnë të zgjeroni mundësitë tuaja të uljes dhe të përdorni hapësirën në mënyrë më efektive. Modelet vijnë në një koleksion të gjerë materialesh, ngjyrash, tapicerie dhe stileshe. Nëse jeni duke kërkuar për karrige që janë të qëndrueshme, stilit të lartë dhe të buxhetit të pranueshëm? Atëherë Megatek është vendi i duhur.

Punoi: Ark. Edona Venxha

DREJTOR I DPPTMKI

NDRIÇIM HOXHA